



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 27 janar 2023
Kodi i ZRRE-së: V_1678_2023

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke u bazuar në:

- Nenit 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenit 15, Nenin 25, Nenit 26 dhe Nenin 42 par. 2 nënpar. 2.3 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Nenit 8 par.1, 2, 4, 8 dhe 11 të Ligjit për Energjinë (Ligji Nr. 05/L-081);
- Dispozitat e Rregullës Nr. 03/2020 dhe Metodologjisë për Përgatitjen e Bilanceve të Energjisë;
- Kërkesën e Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT Sh.A) Nr. 2067, të datës 11/10/2022 për shqyrtim dhe aprovim të Bilancit Vjetor të Energjisë Elektrike për vitin 2023,

në seancën e mbajtur me datë 27 janar 2023, nxori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET - Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike për vitin 2023.**
- II. ZRRE do të monitoroj implementimin e Bilancit Vjetor të Energjisë Elektrike si në dispozitivin nën pikën I. të këtij Vendimi, për të verifikuar realizimin e të dhënave dhe informatave të paraqitura në Bilanc.**

A r s y e t i m

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (në tekstin e mëtejme ZRRE) me datë 11.10.2022 ka pranuar nga Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (në tekstin e mëtejme: KOSTT SH.A.), kërkesën për aprovim të Bilancit Vjetor i Energjisë Elektrike 2023.
- o Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike paraqet planin vjetor të shpenzimit të energjisë elektrike në raport me energjinë elektrike në dispozicion. Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike bazohet në nevojat e planifikuara të konsumit të energjisë elektrike për vitin 2023, i cili është parashikuar



të furnizohet nga gjenerimi vendor dhe importi i energjisë elektrike. Po ashtu në bilanc parashikohet edhe eksportimi i tepricave të energjisë elektrike.

- Qëllimi kryesor i Bilancit Vjetor të Energjisë Elektrike është që të projektojnë përmbushjen e nevojave të konsumatorëve me energji elektrike, në sasi të mjaftueshme gjatë vitit, duke angazhuar kapacitetet e prodhimit dhe transmetimit në mënyrën sa më të mirë tekniko-ekonomike.
- Ministria e Ekonomisë ka paraqitur mendimin nr. prot. 2218 dt. 28.09.2022 për draft dokumentin Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike 2023, ku kanë paraqitur komentet dhe propozimet e tyre në dokumentin përkatës, të cilat i kanë dorëzuar në KOSTT SH.A.
- ZRRE pas shqyrtimit Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike 2023 ka kërkuar që të bëhen ndryshimet në lidhje me: Planifikimin e revizioneve të TC Kosova A, nga 10 ditë sa është propozuar nga KEK, kërkohet të bëhet për 7 ditë; dhe Planifikimin e kërkesës neto në OSSH duhet të jetë mes 2 - 3% me i lart, krahasuar me vitin paraprak, rrjedhimisht, me rritje rreth 2% të kategorisë së konsumatorëve familjar dhe me rritje jo më shumë se 3% të kategorisë së konsumatorëve jofamiljar, krahasuar me realizimin e vitit 2022.
- Bordi i ZRRE-së, ka vlerësuar se duhet të bëhet rishikimi dhe azhurnimet e nevojshme me kërkesat e reja sa u përket parashikimit për energji meqë konsiderojmë që rritja e kërkesës siç është paraparë nga palët nuk është e arsyeshme.
- Ndërsa sa u përket remonteve, kemi konsideruar se remontet e Kosovës A, për shkak se jemi në një krizë energjetike dhe duke marrë parasysh faktin se ka pasur raste kur revizionet kanë shkuar 10 (dhjetë) deri në 12 (dymbëdhjetë) ditë, kërkojmë që të bëhen përpjekjet maksimale që këto revizione të kryhen brenda një periudhe 7 (shtatë) ditore. Nëse një gjë e tillë nuk mund të realizohet, atëherë do të reflektohen nga ZRRE në shqyrtimet e ardhshme të Bilancit Energjetik gjatë vitit të ardhshëm dhe nëse nuk përfundohen brenda periudhës shtatë (7) ditore atëherë do të reflektohen edhe në të hyrat e secilit të licencuar.
- Andaj, duke pasur parasysh trendin e konsumit të realizuar të energjisë elektrike në vitin 2022, si dhe duke marrë parasysh impaktin e bllok tarifës të vendosur në shkurt të vitit 2022 në uljen e konsumit në nivel të shpërndarjes, ZRRE ka konsideruar se ngritja e pritjeve të energjisë elektrike të konsumatorët familjar do të jetë rreth 2%, kurse të konsumatorët jo-familjar pritet të jetë rreth 3% që do të rezultonte me një rritje totale prej 2-3% në nivel të shpërndarjes.
- ZRRE pas vlerësimit të dokumentit ka paraqitur edhe propozimet dhe ndryshimet e nevojshme rreth këtij dokumenti, ku pas përfshirjes së komenteve dhe propozimeve të palëve, dokumenti është propozuar për shqyrtim dhe aprovim.



- ZRRE konsideron se janë përmbushur kriteret për aprovim, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Vendimit i bashkëngjitet dokumenti:

- **Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike 2023**

Bordi i ZRRE-së,

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Izet Rushiti, Anëtar

Selman Hoti, Anëtar

Lutfije Dervishi, Anëtare

Gani Buçaj, Anëtar

Vendimi i dërgohet:

- KOSTT Sh.A.
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji